

Faza e dytë 100 – 200 ditë pas pjelljes

Qëllimi gjatë kësaj faze është që të ruhet sa më gjatë prodhimtaria maksimale.

Kujdes duhet të kemi te trashja e tepërt.

- Koncentrati jo më shumë se 2,3% të peshës trupore.
- Ushqimet voluminoze 1,5% të peshës trupore.

Problemet:

- Rënie e shpejtë e prodhimtarisë së qumështit.
- Shenja të fshehta të afshit.

Faza e tretë

- Prodhimi i qumështit bie, lopa është barse dhe konsumi i ushqimit i tejkalon nevojat, por është më mirë që lopët të shtojnë peshë gjatë kësaj periudhe se sa gjatë tharjes.
- Nëse lopët janë të dobëta, duhet të shtohet me shumë misër gjatë kësaj periudhe.
- Kërkesat për proteina në këtë fazë janë më të ulëta dhe sillen prej 12%
- Lopëve gjatë kësaj kohe duhet të ju sigurohet hapsirë e mjaftueshme për të lëvizur, për të mbajtur kondicionin.

Faza e katërt

- Gjatë kësaj kohe kripa duhet të largohet nga racioni 3 javët e fundit për të ndaluar ënjtjen e gjirit.
- Lopët duhet të ushqehen me sanë e barit jo me jonxhe, arsyeja është sepse jonxha ka sasira më të mëdha të kaliumit dhe në këtë mënyrë shkaktohet disbalanc i mineraleve.
- Të ushqyerit me silazh të misrit në këtë fazë është më i përshtatshëm.
- Sasia e tepërt e kaliumit në racion shkakton sëmundjen e quajtur Parezi i Lindjes. Po ashtu kjo sëmundje shkaktohet edhe nga mungesa e kalciumit në racion.
- Gradualisht duhet të rritet sasia e koncentratit me afrimin e kohës së pjelljes së lopës.

Kualiteti i ushqimeve voluminoze

- Në përgjithësi ushqimet voluminoze përmbajnë përqindje të lartë të celulozës me shumë se 30 %.
- Dhënia e tyre në racion duhet të jetë në formë të vrazhdë me madhësi me shumë se 2,5 cm për të ndihmuar në funksionimin normal të rumenit.
- Zakonisht ushqimet voluminoze kafshët mund ti marrin direkt me anë të kullosjes apo në menyrë të gatshme si san apo silazh.

Kualiteti dhe prodhimtaria

- Një ndër faktorët kryesor që ndikon në kualitetin e ushqimeve voluminoze është faza e kositjes.
- Kositja në fazën e hershme apo në lulëzimin e parë të bimës është masë e domosdoshme që duhet të ndërmerret.
- Kositja e hershme e ushqimeve voluminoze është më e tretshme dhe prodhon mbi 40 % qumësht.
- Kositja e livadheve natyrore duhet të bëhet në kohën e fillimit të kallinjve ndërsa kositja e jonxhës duhet të bëhet para fillimit të lulëzimit

Lartësia e kositjes

- Lartësia minimale e kositjes mbi nivelin e tokës është 6-7 cm.

Vërejtje: Kualiteti, jo Sasia, për kositje e rrisin prodhimin e qumështit në laktacion



TË USHQYRIT E LOPËVE QUMËSHTORE



This project is funded by
The European Union



A project implemented by
(CONTRACTOR)

ZGJEDHJA E HIBRIDIT

Në përgjithësi ushqimet për ripërthypës ndahen në:

- Ushqime voluminoze (racioni bazik) ku bëjnë pjese kullosat, ushqimet e silazhuara dhe llojet barërave
- Ushqimet si burim i energjisë (të gjitha llojet e drithërave)
- Ushqimet proteinike (bërsia e sojës, lulediellit, kolzes etj)
- Nënproduktet e industrisë (Melasa e panxharsheqerit, Himet e grurit, Bërsia e birrës etj.

Lëndët ushqyese

Lëndët ushqyese klasifikohen në 5 grupe: Proteina, Energji, Minerale, Vitamina dhe Ujë panxharsheqerit, Himet e grurit, Bërsia e birrës etj.

Proteinat

Sigurimi i proteinave në racion është i rëndësishëm për mirëmbajtjen e organizmit dhe prodhimtari normale të kafshës.

Proteinat e marruara në racion duhet gjithmonë të jenë të balancuara në bazë të kërkesave të lopëve qumështore.

Qumështi normal përmban afërsisht 3.2 – 3.5 % proteina. Kjo do të thotë që lopa e cila prodhon 100 litra qumësht, largon nga trupi i saj 3.2 deri 3.5 % proteina, për këtë arsye lopa nuk ka mundësi të krijojë rezerva të mëdha të proteinave.

Sigurimi i proteinave në racion stimulon prodhimin e qumështit.

Përqindja e proteinave të përgjithshme tek lopët në laktacion me prodhimtari të lartë të qumështit sillet rreth 16 deri 19 %.

Mungesa e proteinave manifestohet në disa mënyra:

Ulja e shpejtë e prodhimtarisë së qumështit
Lopët që ushqehen me mungesë të proteinave nuk mund të arrijnë pikën më të lartë të prodhimtarisë (kapaciteti gjenetik).

Energjia

Ushqimet për lopët qumështore gjithmonë duhet të përmbajnë energjinë në nivelin e duhur. Burime të energjisë janë: të gjitha llojet e drithërave, silazhi i misrit etj.

Simptomat e mungese së energjisë

- Në periudhën e laktacionit, mungesa e energjisë shkakton humbje të peshës trupore dhe ulje të prodhimtarisë.
- Uljen e pjellorisë së kafshëve.
- 50% e rasteve të jo pjellorisë mund të shkaktohen nga mungesa e ushqimeve dhe menaxhimit të dobët të fermës
- Efektet e energjisë së tepërt në racion janë zakonisht evidentë kur në fermë kemi shumë lopë të trashura së tepërmi.
- Kjo zakonisht ndodhë kur në racion përdorim për një kohë të gjatë vetëm sasi të tepërta të drithërave dhe sillazh të misrit.
- Gjithashtu, lopët trashen së tepëri kur në racion kemi mungesë të proteinave, në këtë mënyrë lopët nuk mund të arrijnë prodhimtarin maksimale.
- Lopët që janë shumë të trasha gjatë pjelljeve janë të prira të kenë lindje të vështira, mbetje të placentës, zhvendosje të abomazusit.
- Mungesa e energjisë po ashtu pengon: rritjen dhe zhvillimin normal të kafshës, pjekjen e qelizave dhe ovulacionin (rritja dhe lirimi i vezëve tek lopët është i dobët apo ndalet), afshi seksual është i vonuar dhe i pa dukshëm.



Mineralet

Mineralet kryesore në balancimin e racionit janë: kalciumi, fosfori, dhe magnezi. Zakonisht natriumin e plotësojmë me kripë.

Uji

Sa i përket lopëve qumështore është llogaritur se nevojiten 3 deri 5 litra ujë për 1 litër qumësht të prodhuar në ditë.

Në sisteme të fermave ku lopët janë të lidhura, çdo dy lope e ndajnë nga një ujë pirëse, kurse në fermat me sistem të lirë, lopët janë të lira dhe ujë pirëset janë më të mëdha dhe shërbejnë për disa lope (10 deri 20 lope).

Është me rëndësi që ujë pirësja të jetë e pastër dhe se valvula të japë mbi 20 litra ujë në minutë, për shkak se lopa brenda një minutë ka mundësi të pije 20 litra ujë.

Të ushqyerit të lopëve ndahet në katër faza:

Faza e parë	0-100 ditë pas pjelljes
Faza e dytë	100-200 ditë pas pjelljes
Faza e tretë	200-300 ditë pas pjelljes
Faza e katërt	45-60 ditë para pjelljes

Faza e parë, kulmi i prodhimtarisë në javën e 4-6-të.

Menjëherë pas pjelljes sasia e koncentratit duhet të shtohet prej 500-700 gr në ditë, por pa kaluar 60% të lëndës së thatë të racionit, pasi ka shfaqje të acidozës.

Proteina në racion 19%

Të përdoret bërsi soje në varësi të prodhimin të qumështit në kufijtë prej 0.5 deri 2 kg.

